



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1119/2 prot.,

Datë 22.05.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Poëer Industries” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-58081-02-06-2023, me objekt: “*Blerje Kazane për mbetje urbane*” me fond limit 29.869.700 (Njëzetë e nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 01.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës

Ankimues: “Poëer Industries” SHPK
Vorë Picar Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës
Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës

Në datën 19.05.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1119 protokollit e operatorit ekonomik “Poëer Industries” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-58081-02-06-2023, me objekt: “*Blerje Kazane për mbetje urbane*” me fond limit 29.869.700 (Njëzetë e nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 01.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Poëer Industries” SHPK .

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “Poëer Industries” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1119prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“operatori ekonomik “Poëer Industries” SHPK nuk plotëson kriteret për kualifikim përkatësisht pikat si më poshtë vijon: 1. Pikën 2.3. të kapacitetit teknik b dhe c : 2.3. b. operatori ekonomik ofertues duhet të jetë I pajisur me certifikatën iso 9001:2015 ose ekivalente , lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme . 1.3.c. operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatën iso 14001:2015 ose ekuivalente lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme pasi të dyja isot-ot e kërkuara nuk përmbajnë objektin e prokurimit . Pikën 2.3.gj ku citohet: Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve prodhuesit/ve te mallrave objekt prokurimi, per te gjitha zerat objekt prokurimi ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte mallrat qe do te ofrohen. U konstatua se katalogu I paraqitur me të dhënat e mallit të ofruar nuk janë conform specifikimeve teknike të mallit të kërkuar nga AK. Ky kriter nuk plotësohet nga operatori ekonomik “Poëer Industries” SHPK .”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 22.05.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri